



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.937/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë, Omer Balić, nga radhët e subjektit politik Strana Demokratske Akcije (SDA), me seli në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Omer Balić kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Strana Demokratske Akcije (SDA), me seli në Pejë, me shenjën ZL.Anr.937/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Omer Balić kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Strana Demokratske Akcije (SDA), me seli në Pejë, me të cilën pretendon se SDA është e vetmja parti e cila është dëmtuar në këto zgjedhjet lokale. Gjithashtu pretendon se numri i votave sipas rezultateve preliminare është 556 vota, ndërsa numri përfundimtar i votave është 488 vota, për Zgjedhjet Komunale në Komunën e Pejës dhe se u janë marr 68 vota, duke mos i llogaritur votat me kusht dhe ato përmes postes. Prandaj, ka kërkuar që apeli të aprovohet si i bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.937/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*